



E K S T R A K T

I procesverbalit i Dëgjimit publik për Anëtarët e Kuvendit Komunal, dhe përfaqësuesit e tyre të lagjes apo më gjerë, mbajtur më 14.7.2023 nga ora 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: Osman Bllaca - kryesues, Valbona Makolli- drejtore e Drejtorisë së Financave, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Mimoza Sylejmani - drejtore e Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit dhe zyrtari Rrahman Qërimi nga Drejtoria e Investimeve Kapitale.

Të pranishëm ishin edhe: Asamblistët e Kuvendit Komunal të Prishtinës, Milazim Vitija, Donjeta Dragusha, Mustafë Krasniqi.

Osman Bllaca, përshëndeti të pranishmit dhe tha se Valbona e KA bëri prezantimin çdoherë, pasi nuk kemi numër të madh të pranishmëve, nuk kam nevojë të bëjë prezantim sepse të gjithë po njihemi, i diskutojmë kërkesat e juaja që i keni për lagjet e juaja, komunitetin e juaj, mund t'i shpallim me qëllim që kërkesa t'i inkorporojmë në buxhetin për vitin 2024.

Donjeta Dragusha: e falënderoi shumë drejtoreshën për përgatitjen e propozimit fillestar të buxhetit. Ajo tha se në buxhetin e këtij viti fshatrat janë përfshirë më pak kësaj here në këtë buxhet, me dallim prej buxhetit të vitit të kaluar. Ajo tha se problemet në fshatin Prugovc, janë adresuar dhe në dëgjimin e kaluar edhe prej Kryetarit të Bashkësisë Lokale të fshatit, mirëpo ajo që më së tepërmi po i preokupon banorët e fshatit është transporti publik dhe mungesa e transportit publik. Ajo tha se kërkesa tjera nuk po dua t'i përsëriti se veç janë adresuar prej Kryetarit të Bashkësisë Lokale, por një kërkesë që është shumë jetike tash për tash është transporti sepse ka veç një operator ekonomik që funksionon në dy fshatrat Prugovc dhe Barilevë, sidomos gjatë verës kur nxënësit dhe studentët janë në pushim.

Mustafë Krasniqi: tha se si banor i fshatit Grashticë, i lagjes "Grashticë e Epërme", kemi nevojë të trajtojmë kanalizimin, ujërat fekale, nuk është ndonjë projekt që mund të kushtojë shumë nga Komuna e Prishtinës, për banorët e lagjes së fshatit Grashticë e Epërme. Ai tha se aty ka shumë të derdhura mbi sipërfaqen e tokës, kundërmon erë, kurse tha se besoj që ta merrni parasysh këtë problem të banorëve, problem i kamotshëm.

Milazim Vitija: - bëri disa kërkesa dhe tha se e përshëndes këtë takim. Ai tha se si Kryetar i Bashkësisë Lkale të Marecit dhe si asamblist po flas për pjesën ku e përfaqësoj unë me të vërtetë një pjesë e lënë pas dore gjatë, duke shtuar se as vitin e kaluar në buxhet nuk është paraparë asnjë cent, për Marecin dhe pjesën e Gollakut. Vitija tha se rrugët janë pothuajse të pakalueshme, kemi pritur që me një buxhet që janë ndarë 1 milion për t'i trajtuar me zhavorr disa rrugë, ajo ende nuk është bërë. Ai tha se ky projekt lidh Komunën e Dardanës me të Prishtinës, është një arterie kryesore që i lidh dy komunat që është projekti i gatshëm dhe me padurim banorët presin që ajo rrugë të ndërtohet sa me parë. Ai tutje tha se në lagjen “Metaj” dhe në lagjen “Hajdaraj”, shumë rrugë që i lidhin lagjet “Gërbesh” dhe lagjen “Llapashticë”, një pjesë me Artanën, nuk kanë kanalizim, nuk kanë ujësjellës, vitin e kaluar kemi dërguar ujë me rezervuar për banorët. Në fund tha se duhet të bëhet kanalizimi dhe ujësjellësi patjetër, së ata pak banorë që vazhdojnë të jetojnë aty edhe ata banorë që i kemi do të shpërngulen në Prishtinë, Hajvali, nëse nuk bëhet kanalizimi dhe ujësjellësi.

Osman Billaca, i falënderoi drejtorët dhe asamblistët që ishin të pranishëm në takim, duke shtuar se ne në Komunë e përmbyllëm ciklin e dëgjimeve për buxhet. Ai tha se në kuadër të një projekti i cili është me USAID-in, dhe quhet projekti “Kontrata Sociale”, kemi buxhetuar 500 mijë euro për projekte të ndryshme të cilat do t'i mbajmë 10 diskutime, dëgjime nëpër lagje dhe fshatra. Billaca, tha se në bazë të pjesëmarrjes së qytetarëve në atë takim, propozimet të cilat dalin për atë lagje dhe për atë komunitet e të cilat marrin vota më së shumti, do të inkorporohen në buxhet. Ai tha se çdo projekt në 100 mijë euro do t'i ndajmë për atë lagje, në qoftë se ka projekte që kushtojnë një projekt përmbyllet me 30 mijë euro, mund t'i inkorporojmë dy projekte aty ose dy projekte nga 50 mijë euro. Tutje tha se ekipi i komunës, mbështetet nga dr. Izeti, Fitimi, Osmani, ku do të organizohen diskutime dhe do të bëhen me vota të fshehta prej USAID-it edhe nga organizatat e shoqërisë publike “D Plus”, të cilat do të na mbështesin në aspektin teknik dhe procedural për organizimin e atyre diskutimeve, kurse anëtarëve të Kuvendit do t'ju shkojë ftesa për këto diskutime me qëllim që të marrin pjesë.

14.07.2023

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Donjeta	Arzuha				
12	Meris	Kryer.				
13	Mustofe	Krasniqi				
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						
26						
27						
28						

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

****Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!****